



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:203087

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05532124

Ac.nr.6981/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Adnan Konushevci dhe Ylber Shurdhiqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.Xh., nga fshati D....., Komuna Gjilan, të cilin me autorizim e përfaqëson N.H., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me përfaqësues M.K., jurist me autorizim, për anulimin e vendimeve, duke vendosur sipas ankesës të së paditurës, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2384/2016 të datës 03.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2384/2016 i datës 03.01.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.2384/2016 të datës 03.01.2020, në pikën një të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi të bazuar kërkesëpadinë e paditësit R.Xh., nga fshati D....., komuna e Gjilanit, dhe e ka anuluar vendimin me nr. referencë 53-KA-D/2014 i datës 26.03.2014 i nxjerrë nga Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, si dhe vendimin me nr. reference 135/KBD/2014, i datës 27.02.2014, i nxjerrë nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor, si dhe e ka detyruar të paditurën që paditësin ta kthejë në punët dhe detyrat që i kishte kryer më parë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, nga data 27.02.2014 e tutje, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Në pikën

dy e ka obliguar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumën prej 374.40 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovon si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta prish si të kundërligjshëm, apo ta lërë në fuqi vendimin e kontestuar si të bazuar në ligj.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit me përgjigje në ankesë, ka propozuar që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi ankimor të vërtetohet, e paditura të obligohet t'i mbuloj shpenzimet për përgjigje në ankesë sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

- *Ankesa është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurës, për anulimin e vendimeve të marra nga e paditura, sipas kërkesëpadisë të cilën e ka precizuar në seancën e datës 14.11.2019, duke kërkuar që të anulohet vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës, nr.135/KBD/2014, i datës 27.02.2014, me të cilin paditësit i është shqiptuar masa disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, dhe vendimi i Komisionit të Ankesave dhe Shpërblimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, nr. 53-KA/D-2014 i datës 26.03.2014, me të cilin është vërtetua vendimi i parë, duke theksuar se kërkesa e paditësit bazohet në prova të pa kontestuara, pasi që me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan PKR.nr.378/2013 të datës 18.09.2013, është hedhur Propozim - akuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.nr.1480/2007 e datës 14.11.2007, e paraqitur ndaj këtu paditësit, për shkak se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale i paraparë me nenin 91, par. 6 të KPK-së, andaj ka kërkuar kthimin e paditësit në punë dhe detyrat të cilat i ka kryer edhe më parë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, nga data 27.02.2014 e tutje, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar duke e aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata ka theksuar se mes palëve ndërgjyqës nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi ishte në marrëdhënie pune me të paditurën, i sistemuar në pozitën e punës si Rreshter i Policisë së Kosovës. Por kontestuese ishte çështja se ndërprerja e kontratës së punës sipas vendimit të paditurës për shkak të procedurave disiplinore ishte e ligjshme apo jo.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për shkeljet që i referohen shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n), pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra tjetrën, ashtu siç e përcakton parag. 3 i nenit 160 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton se me Vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës, nr.135/KBD/2014, i datës 27.02.2014, paditësit i është shqiptuar masa disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, ndërsa me vendimin e Komisionit të Ankesave dhe Shpërblimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, nr. 53-KA/D-2014 i datës 26.03.2014, është vendosur që vendimi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor nr.135/KBD/2014, i datës 27.02.2014, të mbetet në fuqi, për shkeljet e pretenduara sipas parimeve: P-1.16, par. V, seksioni F; P-1.16/VI, seksioni F; P-1.14, neni 9; P-1.16, par. VII, seksioni D; P-1.35, par. II, seksioni B; P-1.16, par. VII, seksioni A1; P-1.16, par. VI, seksioni G; dhe Parimi 1.27, par. II, seksioni C, mirëpo në asnjërin prej këtyre vendimeve të paditurës, nuk përshkruhet se shkeljet e mësipërme të parimeve konsiderohen shkelje të lehta apo të rënda të detyrave të punës, e po ashtu nuk përmendet e as nuk arsyetohet se përse masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës, që i është shqiptuar paditësit, është masë adekuate dhe e bazuar në dispozita ligjore, ashtu siç përcaktohet me nenin 85, par. 1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212.

Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë, ku me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, aktgjykimin e ka bazuar në dispozita konkrete ligjore që i referohen nenit 67 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012 Për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimeve nga ana e të paditurës, e me të cilin parashihet Parashkrimi i shkeljes dhe i ekzekutimit të masës, ku në paragrafin 1. Të tij thuhet: “Shkeljet e rënda disiplinore, parashkruhen, nëse nga koha e kryerjes deri në kohën e zbulimit apo marrjes në dijeni se është kryer shkelja, kanë kaluar 4 vjet, përjashtimisht shkeljet disiplinore nga neni 14 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3., neni 16, neni 17 dhe neni 25 i këtij udhëzimi administrativ”. Gjykata bazuar në dispozitat nënligjore të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, ka vlerësuar se shkeljet e konstatuara nuk bien në kuadër të këtyre dispozitave, nenit 14 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3., neni 16, neni 17 dhe neni 25 i këtij udhëzimi administrativ, për të cilat nuk ka parashkrim, ndërsa për shkeljet e konstatuara nga ana e Komisionit Disiplinor të të paditurës shkeljet e parimeve: P-

1.16, par. V, seksioni F; P-1.16/VI, seksioni F; P-1.14, neni 9; P-1.16, par. VII, seksioni D; P-1.35, par. II, seksioni B; P-1.16, par. VII, seksioni A1; P-1.16, par. VI, seksioni G; dhe Parimi 1.27, par. II, seksioni C, po sipas nenit 67 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, afati i parashkrimit është 4 vjeçar. Padiësi ka kryer shkeljet e pretenduara në muajin Gusht të vitit 2004 dhe Shkurt dhe Korrik të vitit 2007, ndërsa e paditura Komisioni i Brendshme Disiplinor me datën 27.02.2014 ka nxjerr Vendim, i cili vërtetohet nga Komisioni për Ankesa dhe Shpërblime me Vendimin e datës 26.03.2014, me çka, kanë kaluar afër 10 vite nga shkeljet e muajit Gusht të vitit 2004, respektivisht afër 7 vite nga shkeljet për muajin Shkurt dhe Gusht të vitit 2007. Bazuar edhe në dispozitat ligjore, nënligjore referuar parashkrimit të shkeljes disiplinore, del se vendimet e marra nga e paditura janë të kundërligjshme për faktin se shkeljet disiplinore të pretenduara nga ana e padiësit janë të parashkruara. Gjykata e Apelit konkludimin e gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi dhe vjen në përfundim se kërkesëpadia e padiësit është tërësisht e bazuar, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar të pa themeltë ankesën e të paditurës dhe duke e vërtetuar aktgjykimin e atakuar.

Gjithashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, duke qenë se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6981/2021, me datë 27.03.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.